



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 25 tetor 2019  
Nr.re.:RK 1457/19

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI143/18**

Parashtrues

**Bekim Mustafa**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit,  
Ac.nr.3248/17, të 17 korrikut 2018**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Bekim Mustafa me vendbanim në fshatin Pasjak të komunës së Gjilanit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga avokati Halit Azemi nga Gjilani.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Ac.nr.3248/17] e 17 korrikut 2018 të Gjykatës së Apelit.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit [nr. 03/L-121] për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 20 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 9 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 19 tetor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për avokatin e tij, në rast se zgjedh që të përfaqësohet nga ai në procedurat para kësaj Gjykate.
8. Më 24 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin për avokatin e tij.
9. Më 13 shtator 2019, Gjykata e njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj.
10. Më 8 tetor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe, njëzëri, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

*Procedurat gjyqësore të iniciuar përmes padisë së parashtruesit të kërkesës dhe kundërpadisë së palës së interesuar E.B.*

11. Në një datë të pacaktuar parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi kundër palës së interesuar E.B. dhe 12 personave të tjerë, me kërkesën që të vërtetohet e drejta e tij e pronësisë në bazë të trashëgimisë mbi një pronë të paluajtshme. Në anën tjetër, edhe E.B. kishte paraqitur kundër kërkesëpadi ndaj parashtruesit të kërkesës me po të njëjtën kërkesë, pra që e drejta e pronësisë mbi po të njëjtën pronë të paluajtshme të vërtetohet se i takon atij. [Sqarim: kjo pronë e paluajtshme përbën thelbin e gjithë kontestit në këtë rast në mes të parashtruesit të kërkesës dhe E.B.-së].
12. Më 3 korrik 2013, Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [C.nr.548/03] e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në tërësi. Me atë rast, Gjykata Themelore vendosi që: (i) të vërtetojë se parashtruesi i kërkesës është pronar i pronës së paluajtshme; (ii) të urdhërojë E.B.-në që t'ia lirojë pronën e paluajtshme parashtruesit të kërkesës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit; dhe, (iii) të refuzojë kërkesën e paraqitur nga E.B. si kundërpadi ndaj parashtruesit të kërkesës përmes së cilës edhe E.B. kishte kërkuar që të vërtetohet se e drejta e pronësisë mbi të njëjtën pronë të paluajtshme, në fakt, i takon atij dhe jo parashtruesit të kërkesës.
13. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, E.B. paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të zbatimit të gabuar të të drejtës materiale dhe asaj procedurale si dhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Me atë rast, E.B. kërkoi nga Gjykata e Apelit që të ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore ashtu që të refuzojë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe të aprovojë kundërpadinë e tij; ose, si alternativë, të prishë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe gjithë çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje pranë gjykatës së shkallës së parë.
14. Parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigje ndaj ankesës së E.B.-së, me kërkesën që Gjykata e Apelit të vërtetojë në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe të refuzojë ankesën e parashtruar nga E.B.
15. Më 11 nëntor 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac.nr.2951/2013], e pranoi si të bazuar ankesën e E.B.-së vetëm për sa i takon lartësisë së kamatës së gjykuar nga Gjykata Themelore, duke shpjeguar se si do duhej të llogaritej kamata e vendosur. Gjykata e Apelit e vërtetoi gjithë pjesën tjetër të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore duke e refuzuar ankesën e E.B. mbi të gjitha bazat e tjera të ankesës së tij si të pabazuar. Pra, edhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit u konfirmua pronësia e parashtruesit të kërkesës mbi pronën e paluajtshme që ishte objekt kontesti.
16. Kundër Aktgjykimit [Ac.nr.2951/2013] të 11 nëntorit 2016 të Gjykatës së Apelit, E.B. paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të të

drejtës materiale. E.B. i propozoi Gjykatës Supreme që të ndryshojë vendimet e gjykatave më të ulëta ashtu që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar ose të prishen ato vendime dhe e gjithë lënda t'i kthehet Gjykatës Themelore për rigjykim.

17. Më 10 maj 2017, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.56/2017] e pranoi kërkesën për revizion të E.B.-së si të bazuar. Me atë rast, Gjykata Supreme urdhëroi prishjen e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit dhe e ktheu lëndën në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, respektivisht në Gjykatën Themelore.
18. Më specifikisht, Gjykata Supreme e arsyetoi pranimin e revizionit si të bazuar duke theksuar se tani për tani nuk mund të pranohen si të ligjshme dhe të drejta vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta ngase ato *“aktgjykime janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK-së, dhe neni 194 të LPK-së, prandaj të dy aktgjykimet u desh që doemos të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.”* Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas Gjykatës Supreme, qëndronin në atë se ekzistonin kundërthënie ndërmjet dispozitivit dhe arsyeve të dhëna nga Gjykata Themelore dhe kundërthënie në mes të arsyeve për faktet vendimtare. Ndërkaq, tutje, sipas Gjykatës Supreme, në shkallë të dytë Gjykata e Apelit ka qenë e detyruar t'i vejë re shkeljet me të cilat është marrë Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe duke mos i evidentuar ato shkelje edhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.
19. Rezulton që vendimi përfundimtar mbi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe ai mbi kundër kërkesëpadinë e E.B.-së është akoma në pritje për tu zgjidhur pranë Gjykatës Themelore ku edhe është kthyer çështja në rigjykim përmes Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk e konteston Aktvendimin [Rev.nr.56/2017] e 10 majit 2017 të Gjykatës Supreme dhe për rrjedhojë, në vlerësimin e pranueshmërisë së kësaj kërkesë, Gjykata nuk do të merret me vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurave të zhvilluara nga gjykatat e rregullta lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe kundër kërkesëpadinë e E.B.-së. Parashtruesi i kërkesës, para kësaj Gjykate konteston Aktvendimin [Ac.nr.3248/17] e 17 korrikut 2018 të Gjykatës së Apelit dhe për rrjedhojë Gjykata do të vlerësojë kushtetutshmërinë e po atij vendimi. Në paragrafët vijues do të theksohen faktet relevante që kanë ndodhur si pasojë e procedurave përmbartimore të iniciuara nga parashtruesi i kërkesës [bazuar në Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit] dhe procedurave kundërpërmbartimore të iniciuara nga E.B. [bazuar në Aktvendimin e Gjykatës Supreme].

*Procedurat përmbartimore të iniciuara nga parashtruesi i kërkesës dhe ato të kundërpërmbartimit të iniciuara nga E.B. të cilat kulmojnë me Aktvendimin e kontestuar para kësaj Gjykate, respektivisht Aktvendimin [Ac.nr.3248/17] të 17 korrikut 2018 të Gjykatës së Apelit*

20. Më 2 shkurt 2017, akoma pa u marrë Aktvendimi i Gjykatës Supreme përmes së cilit u pranua revizioni i E.B.-së dhe e gjithë çështja u kthye në rigjykim para

Gjykatës Themelore, Përmbauesi Privat përmes Urdhrit [P.nr.46/17] urdhëroi që E.B. si pasojë e Aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit [shih më lart paragrafët 12 dhe 15 të këtij Aktvendimi] të lirojë dhe të zbrazë sendet dhe njerëzit nga prona e paluajtshme që është akoma objekt kontesti por që në atë moment kohe i takonte parashtruesit të kërkesës bazuar në vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë e që ishin bërë të ekzekutueshme pavarësisht faktit që mjeti i jashtëzakonshëm juridik – revizioni – ishte akoma duke u shqyrtuar nga Gjykata Supreme. [Sqarim: Ligji i aplikueshëm në Republikën e Kosovës e lejon iniciimin e procedurës përmbaimore përmes vendimeve të plotfuqishme të një Gjykate Themelore të konfirmuara nga Gjykata e Apelit përkundër faktit që një kërkesë për revizion është akoma në shqyrtim pranë Gjykatës Supreme. Kjo për faktin se kërkesa për revizion si mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk e parandalon zhvillimin e procedurës përmbaimore.]

21. Më 17 mars 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [CPK.31/2017] vërtetoi Urdhrin e lartcekur të Përmbauesit Privat.
22. Më 6 prill 2017, Përmbauesi Privat lëshoi Konkluzionin [P.nr.46/2017] përmes së cilit urdhëroi që më 20 korrik 2017, në orën 11:00, E.B. duhet të jetë i pranishëm dhe i përgatitur me fuqinë e nevojshme punëtore dhe mjetet transportuese me qëllim të lirim të pronës së paluajtshme dhe përfundimit të procedurës përmbaimore në favor të parashtruesit të kërkesës.
23. Nga shkresat e lëndës rezulton që prona e paluajtshme është liruar nga E.B. në favor të parashtruesit të kërkesës.
24. Në ndërkohë, respektivisht më 10 maj 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.56/2017], siç u shpjegua më lart, pranoi revizionin e E.B.-së si të bazuar dhe shfuqizoi Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit përmes së cilave ishte iniciuar procedurat e lartpërmendura përmbaimore dhe përmes së cilave E.B. e kishte liruar pronën e paluajtshme për parashtruesin e kërkesës.
25. Më 13 qershor 2017, respektivisht pas vendimmarrjes së Gjykatës Supreme, E.B. paraqiti një propozim për kundërpërmbaimit në Gjykatën Themelore kundër parashtruesit të kërkesës, me kërkesë që të lirohet, tashmë nga ai, prona e paluajtshme që ishte objekt kontesti së bashku me lokalet dhe objektet afariste që ishin ndërtuar në atë pronë. Propozimin e tij për kundërpërmbaimit E.B. e bazoi pikërisht në Aktvendimin e Gjykatës Supreme.
26. Më 7 korrik 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [CP.nr.34/2017] e aprovoi si të bazuar propozimin për kundërpërmbaimit të E.B.-së dhe e detyroi parashtruesin e kërkesës që në afat prej 7 (shtatë) ditësh t'ia mundësojë E.B.-së kthimin e lokaleve afariste dhe objekteve afariste të ndërtuara në pronën e paluajtshme që ishte objekt kontesti. Gjykata Themelore e arsyetoi vendimmarrjen e saj me sa vijon:

*“Duke u bazuar në nenin 54 pika 1 paragrafi 1.1 i LPP-së, gjykata konstaton se dokumenti përmbaimit në bazë të të cilit është lejuar ekzekutimi dhe është përfunduar ekzekutimi me zbrazjen e*



*paluajtshmërisë [...] është prishur me çka ka ra edhe baza juridike e përmbarimit të dhunshëm, ashtu që propozimi për kundërpërmbarim është i bazuar me ligj dhe debitori E.B. tani kreditor i kundërpërmbarimit ka të drejtën ligjore të kërkesës që të urdhërohet debitori i kundërpërmbarimit Bekim Mustafa [parashtruesi i kërkesës] që t'ia kthejë të gjitha sendet të cilat i ka marrur në bazë të Propozimit për Përmbarim dhe Urdhrit Përmbarimor të Përmbaruesit Privat P.nr.46/17. [...]*

*Prandaj, duke u bazuar në faktin se dokumenti përmbarimor në bazë të të cilit është lëshuar Urdhri Përmbarimor – Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan C.nr.548/03 i 03.07.2013 e i plotfuqishëm më dt. 27.12.2016 është prishur dhe lënda është kthyer në rigjykim [përmes Aktvendimit të Gjykatës Supreme], gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 54 pika 1 nën 1.1. të LPP-së që të fillohet procedura e kundërpërmbarimit.”*

27. Kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje të dispozitave të LPP-së. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata e Apelit që ta deklarojë si të paligjshëm Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore dhe të vendosë që kundërpërmbarimi nuk është i lejuar pa aktgjykim të plotfuqishëm.
28. E.B. paraqiti përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës, me propozimin që e njëjta të refuzohet si e pabazuar ose si e paafatshme.
29. Më 17 korrik 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3248/17] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë e kishte marrë vendimin e saj pa shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës konstitucionale dhe asaj përmbarimore dhe se as *ex officio* e as në bazë të ankesës së parashtruesit të kërkesës nuk mund të gjenden shkelje që do të dërgonin në prishjen e vendimit.
30. Më 15 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës i propozoi Prokurorit të Shtetit që të iniciojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit.
31. Më 3 shtator 2018, Prokurori i Shtetit përmes Njoftimit [KMLC.nr.118/2018] e njoftoi parashtruesin e kërkesës se propozimi i tij nuk është aprovuar meqë në çështjen e tij nuk është gjetur të ketë bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës së tillë.
32. Para Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Ac.nr.3248/17] e 17 korrikut 2018 të Gjykatës së Apelit duke pretenduar se i njëjti është marrë në kundërshtim me të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës.

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës.
34. Për sa i takon këtyre pretendimeve, parashtruesi i kërkesës thekson se ai e ka fituar të drejtën e pronësisë me Aktgjykimin [C.nr.548/03] e 3 korrikut 2013 të Gjykatës Themelore dhe se e njejta e drejtë iu ishte konfirmuar atij përmes Aktgjykimit [Ac.nr.2951/13] të 11 nëntorit 2016 të Gjykatës së Apelit. Pas paraqitjes së kërkesës për revizion nga pala kundërshtare, Gjykata Supreme i ka prishur vendimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit dhe e ka kthyer çështjen në rivendosje. Më pas, thekson parashtruesi i kërkesës, pala kundërshtare ka kërkuar përmes kundërpërmbarrimit që t'i kthehet objekti kontestues në posedim dhe në shfrytëzim të tij. Mirëpo, sipas parashtruesit të kërkesës, *“nuk mund të kërkohej kundërpërmbarrim pa qenë vendimi i formës së prerë sipas nenit 54 al. 1.1 dhe al. 2 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore.”*
35. Gjykata e Apelit, thekson parashtruesi i kërkesës, përmes Aktvendimit të kontestuar e ka refuzuar ankesën e tij dhe e ka vërtetuar Konkluzionin e gjykatës së shkallës së parë. Edhe Prokurori i Shtetit, pas kërkesës së parashtruesit, e ka refuzuar propozimin për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Për këtë arsye, thekson parashtruesi, po i *“drejtohem Gjykatës Kushtetuese për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe për një gjykim të drejtë.”*
36. Në fund, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë si në vijim:
- “Kërkojmë prishjen e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan CP.nr.34/17 dhe të Gjykatës së Apelit Ac.nr.3248/[17] si të paligjshme ngase nuk mund të kërkohej dhe të aprovohej kundërpërmbarrimi pa qenë vendimi i formës së prerë apo i plotfuqishëm nga neni 54 al. 1.1 e 1.2 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, konsiderojmë se rëndë është shkelur mbrojtja gjyqësore e të drejtave të paditësit Bekim si dhe e drejta për marrjen e vendimeve të ligjshme dhe të paanshme nga ana e Gjykatave.”*

## **Pranueshmëria e kërkesës**

37. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113 i Kushtetutës  
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

39. Gjykata më tutje i referohet neneve, 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

*Neni 47  
[Kërkesa individuale]*

*1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

*Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]*

*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

*Neni 49  
[Afatet]*

*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...].*

40. Fillimisht, për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Ac.nr.3248/17] e 17 korrikut 2018 të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
41. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:



*“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*

42. Gjykata rikujton se, përgjatë gjithë kërkesës së tij të dorëzuar në Gjykatë me ndihmën e formularit zyrtar, parashtruesi i kërkesës, në fakt, vetëm ka listuar shkurtimisht faktet e rastit por nuk i ka mbështetur pretendimet e tij se si në fakt Gjykata e Apelit ia ka shkelur atij të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës.
43. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është mjaftuar me një përshtkrim të shkurtër të fakteve dhe me kërkesën e tij që vet Gjykata të gjejë se si potencialisht do të mund të jenë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 dhe 54 të Kushtetutës. Një gjë e tillë bëhet e qartë nga vet kërkesa e tij drejtuar Gjykatës ku thuhet se pas refuzimit të kërkesave të tij nga Gjykata Themelore, e Apelit dhe Prokuroria e Shtetit, po i *“drejtohem Gjykatës Kushtetuese për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe për një gjykim të drejtë.”*
44. Gjykata vë theks të veçantë në atë se nuk është në detyrën e saj që të gjejë shkelje të paargumentuara nga parashtruesit e kërkesës. Është përkundrazi pikërisht detyrë e këtyre të fundit që t'i shpjegojnë Gjykatës, të paktën në thelb dhe në mënyrë substanciale, se si ka ardhur deri te shkeljet e pretenduara të Kushtetutës dhe cilat kanë qenë veprimet konkrete ose mosveprimet e autoriteteve publike që kanë dërguar deri te shkelja e të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara me Kushtetutë. Gjykata nuk mund vetvetiu të shqyrtojë gjithë dosjen dhe të gjejë shkelje *ex officio* dhe pa kërkesë të parashtruesve. Janë këta të fundit që duhet ta drejtojnë Gjykatën drejt gjetjes së shkelje të mundshme dhe ky parim është në përputhje me doktrinën juridike që një gjykatë nuk duhet ta ndërtojë rastin për parashtruesin e kërkesës por që ai vet e ka për obligim që ta ndërtojë rastin e tij me argumente përkatëse kushtetuese.
45. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që pretendimi i vetëm i parashtruesit të kërkesës në mbështetje të pohimit të tij se janë shkelur nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës është se *“nuk mund të kërkohej kundërpërmbarim pa qenë vendimi i formës së prerë sipas nenit 54 al. 1.1 dhe al. 2 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.”*
46. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata rithekson se, në parim, interpretimi i ligjit është kompetencë e gjykatave të rregullta dhe se *“drejtësia”* që kërkohej me nenin 31 të Kushtetutës nuk është drejtësi *“substanciale”*, por drejtësi *“procedurale”*. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës nr. KI42/16 Parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat e tjera të përmendura aty).
47. Për më tepër, Gjykata rikujton arsyetimin e dhënë nga Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj i cili po kontestohet para kësaj Gjykate ku u adresua pretendimi i parashtruesit të kërkesës për interpretim të Ligjit të Procedurës

Përmbarimore. Më specifikisht, lidhur me çështjen e kundërpërmbarimit dhe momenteve se kur ai lejohet, Gjykata e Apelit arsyetoi:

*“Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori i kundër përmbarimit [E.B.] ka parashtruar propozim për kundër përmbarim, duke theksuar se është përmbaruar aktgjykimi i formës së prerë, mirëpo me Aktvendimin Rev.nr.56/2017 i datës 10.05.2017 të Gjykatës Supreme të Kosovës janë anuluar si aktgjykimi i shkallës së parë ashtu edhe aktgjykimi i shkallës së dytë, prandaj ka kërkuar që ti aprovohet propozimi për kundër përmbarim [...]*

*Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës aktvendimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare, e as në ato në të cilat thirret ankesa.*

*Thënie ankimore për shkelje të dispozitave të LPP, konkretisht nenit 54 par. 1.1 nuk qëndron, kjo për arsye se në kuptim të kësaj dispozite debitori ka të drejtë që në të njejtën procedurë përmbarimore edhe pasi të këtë përfunduar përmbarimi të kërkojë nga gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditori që t’ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbarimit në qoftë se dokumenti përmbarues me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar, anuluar, shfuqizuar ose në ndonjë mënyrë tjetër është konstatuar se është i pa efekt juridik.*

*Qëllimi i kundër përmbarimit është në fakt që të detyrohet kreditori pa iniciuar kontest ta kthejë debitorit atë që me përmbarim të dhunshëm ka marrë, kur paraqiten ndonjëra nga arsyet e theksuara në nenin 54 të LPP.”*

48. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës e ndërtoi të gjithë rastin e tij mbi baza ligjshmërie dhe mbi një pretendim të vetëm, përkatësisht mbi interpretimin dhe zbatimin e gabuar të neneve specifike të lartcekura të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI56/17, parashtruese e kërkesës Lumturije Murtezaj, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
49. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e

Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KIo6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 qershorit 2018, paragrafi 57).

50. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KIo6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 38; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58).
51. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se si ky interpretim i ligjit nga Gjykata e Apelit është qartazi i gabuar apo arbitrar dhe të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrarre*” apo “*qartazi të paarsyeshme*”.
52. Gjykata në fund thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm apo edhe për shkeljen e të drejtave në mbrojtje gjyqësore të tyre. (shih rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe, ndër të tjera, KI56/17, cituar më lart, paragrafi 42).
53. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar dhe nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 54 të Kushtetutës.
54. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 8 tetor 2019, njëzëri,

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

